

Opština Djakovica
Përkrahje Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01 Nr./Br. 413/01-39028
Data/Datum 30.12.2024
Gjakovë-Djakovica-Gjakova



Komuna e Gjakovës



KRM "ÇABRATI"

MEMORANDUM MIREKUPTIMI

për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale

E lidhur me datë: 24.12.2021 ndërmjet palëve:

1. Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z. Ardian Gjini, në tekstin vijues theksohet: Komuna.
2. Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM "ÇABRATI", të cilën e përfaqëson z. Behar Ferizi Kryeshef Ekzekutiv i KRM "ÇABRATI", në tekstin vijues theksohet: "ÇABRATI".

Neni 1 Baza ligjore

Në mbështetje të nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 15 të Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina, nenit 9 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 04/L -042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës arrihet Memorandumi i Mirëkuptimit me Kompaninë Regjionale të Mbeturinave KRM "ÇABRATI" **për menaxhimin e mbeturinave komunale.**

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është që të ofrohet mbështetja Kompanisë Regjionale të Mbeturinave KRM "ÇABRATI" për menaxhimin e mbeturinave komunale në përputhje të nenit 1 të këtij memorandumi.

4.2. Kompania KRM "ÇABRATI" është përgjegjëse për:

- a)** nxjerrjen e planit të veprimit për menaxhimin e mbeturinave në përputhje me Ligjin për Mbeturina;
- b)** ofrimin e shërbimeve të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave komunale në përputhje me Ligjin për Mbeturina;
- c)** përgatitjen e raporteve mbi menaxhimin e mbeturinave, si dhe ofrimin e mbështetjes së komunës për definimin e mënyrës së inkasimit dhe rritjes së mbulueshmërisë në ofrimin e shërbimeve në përputhje me Ligjin për Mbeturina
- d)** Menaxhimin e mbeturinave në përputhje me ligjin për Mbeturina.

Neni 5
Kohëzgjatja e Memorandumit

Ky Memorandum fillon së zbatuari nga dt. 24.12.2021 dhe është e vlefshme për një periudhë kohore një (1) vjeçare, deri me 24.12.2022 me mundësi vazhdimi, përveç rastit kur është fjala për zgjidhje të parakohshme të këtij memorandumi të lidhur në mes palëve kontraktuese.

Neni 6
Zgjidhja e Mosmarrëveshjes

Në rast të çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me mos përmbushjen e obligimeve që i kanë palët në këtë memorandum, palët negociojnë në mirëbesim për të arritur një zgjidhje miqësore, në mungesë të konsensusit, kontestin në mes të palëve do ta zgjidh Gjykata Themelore në Gjakovë.

Neni 7

Ky memorandum është e përpiluar në tre (3) kopje, prej të cilave nga një (1) kopje i dorëzohet palës kontraktuese.

PALËT


Ardian Gjini

Kryetari i Komunës së Gjakovës


Behar Ferizi

Kryeshafi Ekzekutiv i KRM "Çabrati"